



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Ref: 1503/206/BA/dk

VENDIMI I BORDIT PËR ANKESA

në çështjen e Ankesës nga

Radio Televizioni i Kosovës

(“Palë Ankuese”)

I përfaqësuar nga:

Z. Naser Gjinovci– RTK

kundër vendimeve të

Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media

(“KPM”)

në Ankesat 2010/6 dhe 2010/9
(Vendimeve të KPM-së të datës 10 mars 2010)

Faktet

1. Me vendimin e tij 2010/6 të datës 10 mars 2010 (Ref: 1002/0236/CMC/Id), Këshilli i KPM-së shqiptoi gjobën prej 50.000 € kundër Palës Ankuese, për transmetimin e komunikimeve komerciale audio-vizuale në kundërshtim me Rregulloren KKPM 2009/04, në veçanti nenin 15.2, për transmetimin e reklamave gjatë kohës së shikueshmërisë së lartë.
2. Më 20 janar 2010, brenda afatit ligjor, Pala Ankuese dorëzoi ankesë kundër vendimit të Këshillit. Pala Ankuese në ankesën e saj thekson se “*ka qenë në proces të tranzicionit dhe se ka vepruar në pajtim me nenin 17, paragrafin 1, nenin 17 paragrafin 2 dhe nenin 17 paragrafin 4 të ligjit numër 02/L-15 për Komisionin e Pavarur për Media. Sipas paragrafit 17.1, procesi i tranzicionit duhet të menaxhohet në aso mënyre që nuk rrezikon aftësinë e transmetuesve publik apo privat që të operojnë arsyeshëm. Si rrjedhojë, Pala Ankuese ka kërkuar nga KPM-ja që të vonojë zbatimin e rregullores për komunikim komercial audio-vizual KKPM 2009/04 të miratuar më 28.8.2009 gjërsa të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme e financimit të Palës Ankuese nga Kuvendi i Kosovës. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ka krijuar pasiguri shtesë për Palën Ankuese në lidhje me gjendjen e saj financiare që*

duhet të merret parasysh. Sidoqoftë gjoba prej 50.000 mijë € nuk është proporcionale me gjendjen ekonomike të Palës Ankuese e cila është dashtë të merret parasysh si faktor lehtësues”.

3. Bordi për Ankesa gjen se Këshilli i KPM-së si organ i shkallës së parë e kishte pranuar kërkesën e Palës Ankuese lidhur me shtyrjen e zbatimit të Rregullores për Reklamim KKPM-2009/04 deri me datën 15 janar 2010.
4. Këshilli i KPM-së si rezultata i shkeljes se vazhdueshme të Rregullores KKPM 2009/04 nga ana e Palës Ankuese me datën 10 mars 2010 morri edhe vendimin e dytë sanksionues me nr. 2010/9 Ref:1003/0239/KKPM/ld, përmes të cilit sanksionojë Palën Ankuese për vendosje të produkteve, respektivisht për shkelje të nenit 19.1 duke shqiptuar kështu gjobën prej 25.000 mijë €. Pala Ankuese edhe kunder këtij vendimi ka bërë ankesë me datë 20 janar 2010, e cila është dorëzuar në afatin ligjor, ku në ankesë ka paraqitur argumentet e njëjta sikurse te vendimi 2010/6. Përveç kësaj, ajo deklaroi se kishte ndaluar vendosjen e produkteve, prandaj nuk duhej të gjobitej.
5. Pala Ankuese me datën 20 janar 2010, ka paraqitur ankesë në Bordin e Ankesave (BA) ndaj Vendimit të Komisionit të KPM-së 2010/09.
6. Për shkak të ngjashmërisë së të dy rasteve dhe argumenteve të paraqitura nga Pala Ankuese në ankesat e saj, Bordi për Ankesa pas marrjes së pajtimit nga të dyja palët, vendosi që të bashkojë të dyja rastet për qëllime të procedurës.
7. Bordi për Ankesa konstatoj se Pala Ankuese nuk kishte mungesë financiare pasi që Kuvendi i Kosovës ka ndarë fonde të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha nevojat financiare të Palës Ankuese. Bordi për Ankesa gjithashtu konstaton se Pala Ankuese nuk kishte refuzuar raportet e monitorimit se ishte në shkelje të Rregullores për komunikim komercial audio-vizual. Në veçanti Pala Ankuëse kishte vepruar vazhdimisht në kundërshtim me nenin 15.2 të rregullores sipas së cilës reklamimi, teleshoppingu dhe videospotet në kanalet e shërbimit publik nuk mund të transmetohen në mes të orës 07:00 dhe 09:00 të paradites dhe në mes të orës 18:00 dhe 23:00 të mbrëmjes.
8. Në lidhje me çështjen e vendosjes së produkteve, të dyja palët u pajtuan se ka pasur shkelje në të kaluarën, por se Pala Ankuese ndërkohë është kthyer në pajtueshmëri duke eliminuar kryesisht vendosjen e produkteve, edhe pse kanë mbetur disa përjashtime.
9. Bordi për Ankesa bazuar në raportin e monitorimit të datës 19 janar 2010, pas analizimit të raportit ka gjetur se Pala Ankuese ka transmetuar komunikime komerciale audio-vizuale në kundërshtim me Rregulloren për Komunikime Komerciale audio-vizuale 2009/04, respektivisht me nenin 15.2 të kësaj rregulloreje.
10. Me datën 20 janar 2010, Palës Ankuese i është dërguar letër më të cilën i është sqaruar se është duke vepruar në kundërshtim me Rregulloren KKPM-2009/04, respektivisht me nenin 15.2 dhe me këtë rast Pala Ankuese është udhëzuar që të veprojnë në pajtueshmëri me këtë rregullore.
11. Pala Ankuese me datën 20 janar 2010, ka paraqitur ankesë në Bordin e Ankesave (BA) ndaj Vendimit të Komisionit të KPM-së 2010/06.

12. KPM ka vazhduar monitorimin e Palës Ankuese edhe me datën 23 janar 2010. Bordi për Ankesa pas analizimit të këtij raportit përsëri ka gjetur se Pala Ankuese ka vazhduar të jetë në kundërshtim me nenin 15.2 të Rregullores KKPM 2009/04, duke transmetuar komunikime komerciale në kohën kur nuk lejohet transmetimi i komunikimeve komerciale për Transmetuesin Publik.
13. Bordi për Ankesa duke u bazuar në raportin e monitorimit të datës 19 dhe 25 janar 2010 gjen se Pala Ankuese ka verpuar në kundërshtim me Rregulloren KKPM-2009/04. Bordi për Ankesa gjithashtu gjen se me datën 26 janar 2010, Palës Ankuese i është dërguar Njoftim për Shkelje për shkelje të Rregullores KKPM 2009/04, duke e udhëzuar të veproj në pajtueshmëri me rregulloren KKPM 2009/04, si dhe të përgjigjet me shkrim për shkeljet e bëra.
14. Bordi për Ankesa gjen se Komisioni i KPM-së me datën 1 shkurt 2010, ka mbajtur një takim me anëtarët e Bordit të Palës Ankuese. Bordi për Ankesa ka konstatuar se Komisioni i KPM-së në këtë takim i ka kërkuar Palës Ankuesë të respektoj zbatimin e Rregullores për Komunikime Komerciale audio-vizuale KKPM 2009/04, pavarësisht ankesës së paraqitur nga Pala Ankuese pranë Bordit për Ankesa.
15. Pala Ankuese me datën 20 janar 2010, ka parashtruar ankesë kundër Rregullores KKPM-2009/04. Bordi për Ankesa me datën 2 shkurt 2010, në pajtim me nenin 21.3 të Ligjit për KPM-në, ka hedhur poshtë ankesën e, si të palejuar duke sqaruar se BA nuk është i autorizuar të shqyrtoj rregulloret si të tilla, por vetëm Vendimet e nxjerra nga Këshilli i KPM-së të bazuara në aktet nënligjore të KPM-së.
16. Edhe pas Njoftimit për Shkelje, është vazhduar me monitorimin e programeve të Palës Ankuese për të verifikuar pajtueshmërinë me Rregulloren KKPM 2009/04, dhe në bazë të raporteve të vazhdueshme të monitorimit, si dhe pas analizimit të këtyre raporteve, Bordi për Ankesa ka konstatuar se Pala Ankuese në mënyrë të vazhdueshme ka transmetuar komunikime komerciale audio vizuale në kundërshtim me nenin 15.2 rregullores KKPM 2009/04.
17. Bordi për Ankesa ka gjetur se Palës Ankuese i është dërguar edhe Vërejtje me shkrim, ku përfundimisht i është bërë më dije se për çfarëdo shkelje të mëtutjeshme të Rregullores KKPM 2009/04, Komisioni i KPM-së do të ndërmerr masa ligjore bazuar në Ligjin e KPM-së.
18. Bordi për Ankesa bazuar në raportet e monitorimit të datës 15 janar deri me 28 shkurt 2010, ka gjetur se edhe përkundër Vërejtjes së marrë Pala Ankuese vazhdon të jetë në kundërshtim me Rregulloren KKPM 2009/04, duke transmetuar komunikime komerciale audio vizuale në kohën e ndalimit për transmetimin e tyre.
19. Bazuar në raportet e monitorimit, Bordi për Ankesa pas analizimit të raporteve ka gjetur se Pala Ankuese ka pasur vendosje të produkteve në serialet vendore “Familja Moderne”, transmetuar më 17 janar 2010, dhe “Kafeneja jonë” transmetuar më 18 janar 2010. Transmetimi i vendosjes së produkteve, si formë e komunikimit komercial është në kundërshtim të plotë me nenin 19.1 të Rregullores KKPM 2009/04.
20. Me datën 20 janar 2010, Palës Ankuese, i është dërguar letër me anë të së cilës i është sqaruar se është duke vepruar në kundërshtim me Rregulloren KKPM 2009/04, respektivisht me nenin 19.1 dhe me këtë rast Pala Ankuese është udhëzuar që të veproj në pajtueshmëri me këtë rregullore.

21. Bordi për Ankesa gjen se KPM ka vazhduar me monitorimin e programeve të Palës Ankuese, ku Bordi për Ankesa pas analizimit të raporteve ka gjetur se Pala Ankuese në mënyrë të vazhdueshme ka vepruar në kundërshtim me nenin 19.1 të Rregullores 2009/04, pasi që Pala Ankuese ka pasur vendosje të produkteve në serialet vendore “Familja Moderne”, të transmetuar më 24 janar 2010, dhe “Kafeneja jonë” të transmetuar më 25 janar 2010. Edhe në këtë rast transmetimi i vendosjes së produkteve, si formë e komunikimit komercial është në kundërshtim të plotë me nenin 19.1 Rregullores KKPM 2009/04.
22. Bordi për Ankesa ka gjetur se Palës Ankuese me datën 26 janar 2010, i është dërguar Njoftim për Shkelje për shkelje të Rregullores KKPM 2009/04, duke e udhëzuar të veprojë në pajtueshmëri me Rregulloren KKPM 2009/04, si dhe të përgjigjet me shkrim për shkeljet e bëra.
23. KPM, ka vazhduar me monitorimin e programeve të Palës Ankuese për të verifikuar pajtueshmërinë me Rregulloren KKPM 2009/04. Pas analizimit të këtyre raporteve Bordi për Ankesa ka konstatuar se Pala Ankuese, edhe pas marrjes së Njoftimit për Shkelje, ka pasur vendosje të produkteve në episodet e serialeve të transmetuara nga Pala Përgjegjëse, duke bërë shkelje të vazhdueshme të nenit 19.1 të Rregullores KKPM 2009/04.
24. Bordi për Ankesa bazuar në raportin e monitorimit të datës 2 shkurt 2010, ka gjetur se Palës Ankuese i është dërguar Vërejtje me shkrim, ku përfundimisht i është bërë me dije se për çfarëdo shkelje të mëtutjeshme të Rregullores KKPM 2009/04, Këshilli i KPM-së do të ndërmarr masa ligjore në bazë të Ligjit të KPM-së.
25. Prej datës 15 janar deri më 28 shkurt 2010, është bërë monitorimi i Palës Ankuese, ku Bordi për Ankesa ka gjetur se edhe përkundër Vërejtjes së marrë Pala Ankuese vazhdon të jetë në kundërshtim me Rregulloren KKPM 2009/04, pasi që ka transmetuar katër episode të serialit “Familja Moderne” dhe gjashtë episode të serialit “Kafeneja Jonë” në të cilat ka pasur vendosje të produkteve të cilat kanë qenë në kundërshtim të plotë me nenin 19.1 të Rregullores KKPM 2009/04.
26. Bordi për Ankesa, gjithashtu bazuar në raportin e fundit të monitorimit të datës 8 mars 2010, ka gjetur se Pala Ankuese ka pasur vendosje të produkteve vazhdimisht edhe në kuizin “Kush do të bëhet Milioner” i cili është transmetuar me datat 18 dhe 25 janar 2010, si dhe me datat 1,8,15 dhe 22 shkurt 2010. Vendosja e produkteve në transmetuesin publik si formë e komunikimit komercial është në kundërshtim të plotë me nenin 19.1 të Rregullores KKPM 2009/04.

Vendimi

27. Bordi për Ankesa (BA) pas vlerësimit dhe analizimit të rasteve vendosi që të bashkojë rastet 2010/6 dhe 2010/9, për shkak të ngjashmërisë së tyre, për qëllime të procedurës.
28. Bordi për Ankesa pas shqyrtimit të argumenteve të paraqitura nga KPM dhe Pala Ankuese, konstatoi se Vendimet e Komisionit të KPM-së janë të argumentuara dhe të bazuara në Rregulloren për Komunikime Komerciale, në Ligjin e KPM-së dhe në gjendjen faktike.

29. Bordi për Ankesa duke u bazuar në faktin se Pala Ankuese pjesërisht ka ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren KKPM 2009/04, duke e hequr vendosjen e produkteve, si dhe duke u bazuar në gjendjen e padefinuar financiare me të cilën Pala Ankuese ballafaqohet, në pajtim me nenin 36, paragrafi 3, të Ligjit të KPM-së vendosi që Vendimi Nr. 2010/06 nga shuma 50 mijë euro të zbritet në 35 mijë euro, ndërsa Vendimi Nr.2010/09 nga shuma 25 mijë euro të zbritet në 15 mijë euro.

Arsyetimi

30. Bordi për Ankesa në seancën mbajtur me datë 3 mars 2015, ka bërë shqyrtimin dhe analizimin e të gjitha fakteve, shkresave të lëndës përfshi këtu të gjitha raportet e monitorimit dhe dokumentet tjera relevante siç janë Njoftimet për Shkelje dhe Vërejtjet të cilat i janë dërguara Palës Ankuese.
31. Bordi për Ankesa gjatë analizimit të raporteve të monitorimit, ka gjetur se Pala Ankuese në mënyrë të vazhdueshme ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren KKPM-2009/04, përkatësisht nenin 15, paragrafi 2, i cili thekson se:

“Komunikimet komerciale audiovizuale dhe spotet e teleshoppingut në kanale të shërbyesit audiovizual publik nuk mund të transmetohen prej orës 07:00 deri 09:00 dhe prej orës 18:00 deri në orën 23:00”.

32. Bordi për Ankesa gjen se Pala Ankuese nuk e konteston shkeljen e Rregullores KKPM-2009/04, mirëpo e thekson se këto vendime janë marr në kohën kur Palës Ankuese iu ka ndërprerë financimi me parapagim.

33. Bordi për Ankesa duke u bazuar në raportet e monitorimit të KPM-së gjithashtu ka gjetur se Pala Ankuesë edhe pas pranimit të shkresave të dërguara nga KPM në të cilat i është bërë me dije se është në shkelje të Rregullores KKPM-2009/04, dhe është kërkuar të veprojë në pajtim me Rregulloren KKPM-2009/04, ka vazhduar të mos respektojë këtë Rregullore duke transmetuar komunikime komerciale audiovizuale në kundërshtim me nenin 15.2.

34. Bordi për Ankesa duke u bazuar në raportet e monitorimit gjithashtu konstaton se, Pala Ankuese ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 19, paragrafi 1, të Rregullores KKPM-2009/04, i cili thekson se:

“Vendosja e produkteve ndalohet në kanalet e subjektit transmetues publik”.

35. Bordi i Ankesave duke u bazuar në raportet e e monitorimit të KPM-së ka gjetur se Pala Ankuese edhe pas pranimit të shkresave të dërguara nga KPM në të cilat i është bërë me dije se është në shkelje të Rregullores KKPM-2009/04, pasi që në mënyrë të vazhdueshme ka pasur vendosje të produkteve, ka vazhduar të veproj në shkelje të nenit 19, paragrafi 1, të Rregullores KKPM-2009/04.

36. Bordi për Ankesa gjithashtu nuk konsideron se është punë e tyre që të diskutojnë mënyrën se si sigurohet financimi i duhur i Palës Ankuese si transmetues publik. Bordi i Ankesa ka vepruar dhe ka shqyrtuar rastin në mënyre të drejtë duke mos shkelur dispozitat materiale e as procedurale, duke vepruar kështu në pajtim me nenin 36 paragrafi 3 të Ligjit të KPM-së i cili thekson se Bordi për Ankesa mund të mbështes, ndryshojë ose shfuqizojë çdo vendim të KPM-së.

37. Prandaj Bordi për Ankese bazuar në raportet e monitorimit, shkresat e lëndës përfshi Njoftimet për Shkelje dhe Vërejtjet me shkrim, ka konstatuar se Pala Ankuese ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuale KKPM 2009/4.

Rishikim procedural

38. Vendimet e bordit janë përfundimtare në pajtim me nenin 44.2 të Ligjit për KPM-në.
39. Palët në vendim mund të dorëzojnë kërkesën për rishikim procedural në Gjykatë Supreme të Kosovës në pajtim me ligjin e aplikueshëm.
40. Inicimi i rishikimit procedural nuk ndalon zbatimin e vendimeve të Komisionit të KPM-së ashtu siç mbështeten apo modifikohen nga Bordi.


Daut KRASNIQI
Kryetar, Bordi për Ankese



03.03.2015
data